

PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE

Menstruacionet nuk janë luks. Përse po i tatojmë ato?

Përgatitur nga Elirjeta Beka për Rrjetin e Grave të Kosovës

Hyrje

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGj) është obligim ligjor në Kosovë.¹ Prandaj, të gjitha institucionet publike duhet të marrin parasysh nevojat e grave dhe vajzave në buxhetet dhe politikat e tyre. Kjo përfshin sigurimin e qasjes së barabartë në mallrat dhe shërbimet thelbësore, të tilla si produktet e higjienës menstruale. Menaxhimi i higjienës menstruale është e drejtë themelore e njeriut e paraparë në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara (OKB) për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR). Kufizimi i qasjes së grave dhe vajzave në produkte higjienike menstruale me kosto të përballeshme shkel të drejtat e tyre për kujdes shëndetësor, dinjitet dhe arsim. Për më tepër, menaxhimi i higjienës menstruale është thelbësor për arritjen e disa [Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm \(OZHQ-ve\)](#) që janë miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 2015, e për të cilat është zotuar Qeveria e Kosovës. [OZHQ 3](#) promovon jetë të shëndetshme dhe mirëqenie për të gjitha moshat, [OZHQ 4](#) siguron arsim gjithëpërfshirës dhe cilësor, kurse [OZHQ 5](#) ka për synim arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave. Ndonëse CEDAW² dhe ICESCR³ nuk e përmendin drejtpërdrejt shëndetin menstrual si një të drejtë të veçantë, disa nene e mbështesin atë në mënyrë indirekte. Kjo përmbledhje e politikave nxit qeverinë e Kosovë që të heqë tatimin për produktet e higjienës menstruale, gjë që do të përmirësonte mirëqenien e grave dhe vajzave dhe do të përputhej me zotimet e Kosovës për OZHQ-të, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe zbatimin e BPGJ-së.

Analizë e situatës

Sipas Ligjit të tanishëm nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe Udhëzimet e tij Administrative, produktet menstruale i nënshtrohen normës standarde të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) prej 18%, të ngjashme sikurse për mallrat e luksit.⁴ Kjo rëndon në mënyrë të padrejtë gratë dhe vajzat, veçanërisht ato nga familjet me të ardhura të ulëta. Sipas hulumtimit të EcoKosWomen, një grua shpenzon 56 € në vit për produkte menstruale,⁵ që është një

¹ [Ligji nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore, neni 1.17.](#)

² UN, CEDAW, [nenet 3 dhe 10.](#)

³ UN, ICESCR, [nenet 6, 7b, 12 dhe 13.](#)

⁴ [Ligji nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar](#); Udhëzimet Administrative 03/2015 për zbatimin e Ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

⁵ EcoKosWomen, "Promovimi i të drejtave të njeriut përmes buxhetimit të përgjegjshëm gjinor: Zvogëlimi i taksave për produktet esenciale të higjienës menstruale", 2021.



shpenzim i konsiderueshëm duke pasur parasysh shkallën e ulët të punësimit të grave në Kosovë (18.7%).⁶ Ndërkohë, heqja e këtij tatimi nuk do të ndikonte shumë në të ardhurat e qeverisë. Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, TVSH-ja (0.05%) dhe tatimi doganor (0.01%) mbi produktet për higjienën menstruale përbëjnë vetëm 0.065% të të ardhurave totale vjetore doganore. Pra, tatimi i këtyre produkteve thelbësore do të sjellë shumë pak përfitime për qeverinë, ndërkohë që do të shtojë një barrë të konsiderueshme për gratë dhe vajzat, të cilat janë ndër më të rrezikuarat ekonomikisht. Në të kundërtën, heqja e tatimit do të përçojë një mesazh të fuqishëm se menstruacionet janë një funksion normal i trupit dhe nuk duhet të shkaktojnë turp ose vështirësi financiare.

Zgjidhja: Të ndiqet shembulli i Mbretërisë së Bashkuar

Kosova duhet të ndjekë shembullin e Mbretërisë së Bashkuar në heqjen e “taksës së tamponit” mbi produktet sanitare. Mbretëria e Bashkuar ka zbatuar një normë zero TVSH për këta artikuj thelbësorë, duke i bërë ata më të përbalueshëm për të gjitha gratë. Ky ndryshim përputhet me strategjinë e tyre më të gjerë për të luftuar varfërinë menstruale, e cila gjithashtu përfshin ofrimin e produkteve falas në shkolla dhe spitale. Me ligjin e BE-së që kërkonte një TVSH minimale prej 5% për produktet sanitare, Mbretëria e Bashkuar ishte e detyruar më parë të respektojë këtë kufizim. Mundësia për ndryshim u hap pas përfundimit të periudhës së tranzicionit. Kosova mund të miratojë legjislacion të ngjashëm me normë zero TVSH, duke siguruar që produktet menstruale të jenë të përbalueshme dhe duke konsideruar themelimin e një Fondi për Higjienën Menstruale për të mbështetur gratë e cenueshme.

Opsionet alternative të të ardhurave

Të ardhurat e humbura nga heqja e tatimeve mbi produktet menstruale mund të kompensohen duke rritur tatimet për makinat luksoze dhe akcizën për alkoolin. Vënia e tatimit mbi makinat luksoze synon individët që mund ta përballojnë atë dhe është në përputhje me parimin ‘ndotësi paguan’.⁷ Rritja e akcizës për alkoolin do të gjeneronte dukshëm më shumë të ardhura sesa tatimet për produktet menstruale.

Rekomandimi

Në përputhje me detyrimet e qeverisë për të zbatuar BPGj-në, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet të ndryshojë urgjentisht Ligjin nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, si dhe Udhëzimin Administrativ MF Nr. 03/2015 për Zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, për të përjashtuar produktet e higjienës menstruale nga të gjitha tatimet doganore dhe TVSH-ja. Më tej, ky ligj duhet të ndalojë bizneset që të rrisin çmimet pas heqjes së tatimit duke nxjerrë një vendim apo rregullore përmes së cilës do të vendosen mekanizmat mbikëqyrës. Qeveria duhet të monitorojë në mënyrë aktive bizneset për të siguruar respektimin e kësaj rregulloreje.

⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës, [Shkalla e papunësisë sipas gjinisë](#).

⁷ Parimi “ndotësi paguan” nënkupton se ata që shkaktojnë ndotje duhet të paguajnë për koston e menaxhimit të saj për të parandaluar dëmtimet në shëndetin e njerëzve ose në mjedis.